



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:280211

Datë: 17.04.2024

Numri i dokumentit: 05586621

C.nr.1422/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.H, si dhe paditësve B1.Hdhe B.M, të gjithë nga fshati Ratkoc, komuna e Rahovecit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati S.M nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, me bazë juridike kompensimi i ushqimit në punë, vlera e objektit të kontestit 2,070.00 euro, jashtë seancës, më datën 17.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR kërkespadija e paditëses B.H.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses B.H, nënë emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 22.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 345 ditë pune të ja paguajë shumën prej 690.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 11.12.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm
- III. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkespadija e paditësve B1.Hdhe B.M.
- IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit B1.H, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 18.04.2021 e deri më datën 21.12.2021 për 278 ditë pune të ja paguajë shumën prej 556.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 11.12.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.
- V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit B.M, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 18.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 278 ditë pune të ja paguajë shumën

prej 556.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 11.12.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

- VI. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit B1.Hpër pjesën tjetër të padisë lidhur me kompensimin e ushqimit në punë mbi shumën prej 556 euro e deri në shumën prej 690 euro dhe atë për shumën prej 134 euro.
- VII. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit B.M për pjesën tjetër të padisë lidhur me kompensimin e ushqimit në punë mbi shumën prej 556 euro e deri në shumën prej 690 euro dhe atë për shumën prej 134 euro.
- VIII. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve B.H, B1.Hdhe B.M, t’i paguajë shumën prej 228.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja B.H si dhe paditësit B1.Hdhe B.M, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, më datën 11.12.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për kompensimin e ushqimit në punë në shumën prej 2,070.00 euro.

Të njejtit sipas padisë kanë theksuar se kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë si mësimdhënës në SHFMU “4 Dëshmorët” në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit, e që për periudhën e kërkuar paditëses i ka takuar e drejta e kompensimit të ushqimit në punë sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës të datës 22.02.2021, por që deri më tani nuk është kompensuar. Periudha e kërkuar sipas padisë është nga data 22.01.2021 e deri më 21.11.2022 dhe atë për 345 ditë të prezencës në punë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 03.04.2024, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi për shkak se drejta për kompensim mbi bazën në të cilën janë thirrur palët paditëse rezulton e pavlefshme. Më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Ndërkaq kërkesat që dalin nga kontestet e marrëdhënies së punës fillimisht duhet të parashtrohen tek punëdhënësi. Gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësit i kanë shtjerrë të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Në këtë rast paditësit nuk kanë parashtruar kërkesë për kompensim pranë të paditurës. Me asnjë provë nuk është vërtetuar se paditësja ka bërë shpenzimin e drejtpërdrejtë të udhëtimit në emër të saj. Për më tepër paditësit B1.Hdhe B.M janë kompensuar për periudhën 22.01.2021 deri me 18.04.2021, me aktgjykimet C.nr.162/21 dhe C.nr.169/21. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: për paditësen B.H, vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/10 i datës 20.02.2023, i lëshuar nga SHFMU “4 Dëshmorët” në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit; kontratën e punës për mësimdhënëse me Nr. të protokollit 01/288, e datës 09.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses B.H.

Për paditësin B1.H: vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/11 i datës 20.02.2023, i lëshuar nga SHFMU “4 Dëshmorët” në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit; kontratën e punës për mësimdhënëse me Nr. të protokollit 01/128, e datës 01.09.2020, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit B1.H.

Për paditësin: B.M, vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/21 i datës 20.02.2023, i lëshuar nga SHFMU “4 Dëshmorët” në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit; kontratën e punës për mësimdhënëse me Nr. të protokollit 01/291, e datës 09.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit B.M.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësit kanë të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësit për periudhën e kërkuar kohore kanë prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësve pagesa e ushqimit për çdo ditë të prezencës në punë.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/10 i datës 20.02.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësja B.H në periudhën kohore prej datës 22.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 345 ditët e punës.

Me administrimin e kontratës e punës për mësimdhënëse me Nr. të protokollit 01/128, e datës 01.09.2020, të lidhur ndërmjet paditësit B1.H dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “4 Dëshmorët” në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/11 i datës 20.02.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësi B1.H në periudhën kohore prej datës 22.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 345 ditët e punës.

Me administrimin e kontratës e punës për mësimdhënëse me Nr. të protokollit 01/291, e datës 09.09.2015, të lidhur ndërmjet paditësit B.M dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “4 Dëshmorët” në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/21 i datës 20.02.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësi B.M në periudhën kohore prej datës 22.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 345 ditët e punës.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë pjesën e kërkesëpadisë të paditëses për faktin se paditësja në periudhën kohore nga data 22.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 në vendin e saj të punës ka

prezantuar në 345 ditët e punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimit të lëshuar nga vetë shkolla ku paditësja ka qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti nuk e ka kontestuar as e paditura. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Ndërsa sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore”*. Në rast se shumëzohen 345 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 690 euro.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë pjesërisht pjesën e kërkesëpadisë të paditësve B1.H dhe B.M për faktin se paditësit në periudhën kohore nga data 18.04.2021 e deri më datën 21.12.2021 në vendin e tyre të punës kanë prezantuar në 278 ditët e punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimit të lëshuar nga vetë shkolla ku paditësi ka qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti nuk e ka kontestuar as e paditura. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Ndërsa sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore”*. Në rast se shumëzohen 278 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 556.00 euro.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Gjykata ka vendosur si në pikën VI dhe VII të dispozitivit të aktgjykimit dhe e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë lidhur me kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë mbi shumën prej 556 euro e deri në shumën prej 690 euro dhe atë për shumën prej 134 euro. Paditësit sipas kërkesëpadisë kanë kërkuar kompensim lidhur me shpenzimet për ushqim në punë me pretendime se çmimi i shujtës ditore prej 2 euro për periudhën 21.01.2021 deri më 21.11.2022. Gjykata në kë çështje juridike ka vërtetuar faktin se:

Me Aktgjykim C.nr.162/2021, me numër të lëndës 2021:050885, paditësit B1.H, i është aprovuar kërkesëpadia për kompensimin e ushqimit, për periudhën kohore nga 21.11.2019 – 18.04.2021, andaj edhe e ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë mbi këtë shumë dhe atë për periudhën 22.01.2021 deri më 18.04.2021.

Me Aktgjykim C.nr.169/2021, paditësit B.M, i është aprovuar kërkesëpadia për kompensimin e ushqimit, për periudhën kohore nga 21.11.2019 – 18.04.2021, andaj gjykata edhe e ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë mbi këtë shumë dhe atë për periudhën 22.01.2021 deri më 18.04.2021.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur*

gjkata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin merit me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se “Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.

Vendimin lidhur me kumatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, duke vendosur që e paditura t'ia kompensojë të paditëses shumën si në pikën VIII të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 228 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 208 euro si dhe për taksën gjyqësore 20.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.1422/2023, më datën 17.04.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari
Avni Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.